



Prishtinë: 27.02.2009

Kodi i ZRRE-së: V\_162\_2009

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_175\_12\_08

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK\_V\_175\_12\_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

**Në mbledhjen e mbajtur më 27 shkurt 2009 nxori këtë:**

### VENDIM

**REFUZHET** ankesa e konsumatorit Slavkoviq Spiro / ankuesja Iliriane Ademi (shifra e konsumatorit DPR – 40377) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 23.09.2008 ka kundërshtuar heshtjen administrative të KEK Sh.A lidhur me kundërshtimin e konsumatorit për faturim pa matje – paushall.

- Me datë 09.03.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK, duke kundërshtuar faturimin pa matje – paushall.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK.

- Me datë 18.03.2008 me kërkesën e konsumatorit ekipi i autorizuar i kontrollës ka dalur tek konsumatori dhe kanë konstatuar se tani konsumatori faturohet në bazë të harxhimit pasi që nuk ka jetuar askush në këtë shtëpi qe dy vite.

**Provë:** Procesverbali nr. 0118964 të datës 18.03.2008.

- Me datë 19.05.2008 konsumatori i lartpërmendur ka nënshkruar kontratën për shitblerje të pronës me konsumatorin Iliriane Ademi në fshatin Bërnice e Epërme.

**Provë:** Kontrata e shitblerjes.

- Me datë 12.05.2008 Drejtorati i Administratës së Përgjithshme – Sektori i Bashkësisë Lokale ka lëshuar një Vërtetim në të cilin theksohet se Apostol Slavkoviq ka jetuar me familje deri më 2003 dhe pas kësaj ka jetuar në fshatin Graqanicë.

**Provë:** Vërtetimi nr. 154/08 i datës 12.05.2008 nga Drejtorati i Administratës së Përgjithshme – Sektori i Bashkësisë Lokale.



- Me datë 02.10.2008 KEK-u ka bërë një korigjim të paushallit (faturat prej 02/2002 e deri më 02/2003) me anë të Urdhër Lejimit / Ngarkimit nr. 18065 të datës 02.10.2008, ku vlera e korigjimit është 258.75 €.

**Provë:** Urdhër Lejimit / Ngarkimit nr. 18065 i datës 02.10.2008.

- Me datë 20.01.2009 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka pranuar pjesërisht ankesën e konsumatorit.

**Provë:** Përgjigja e DMK në ZRRE e datës 20.01.2009.

- Me datë 09.02.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_175\_12\_08.

**Provë:** Ankesa e konsumatorit drejtuar Bordit të ZRRE-së me datë 09.02.2009.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK\_V\_175\_12\_08** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi.

Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyt e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, brenda **katërbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar